



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 58, shkronja h të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 1, të Ligjit nr. 04/L - 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 5 të Rregullorës QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01. nr.569 të dt. 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 31 tetor 2014, merr këtë:

V E N D I M

I. Me këtë vendim lejohet shpallja e ankandit-tenderit publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit në shfrytëzim-me qera të lokaleve, personave fizik/juridik për afat prej 3-5 vitesh, duke filluar nga data 01.01.2015

II. Komisioni vlersues për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim do të bëjë vlerësimin e ofertave të arritura në bazë të ankandit -tenderit publik të shpallur dhe atë më së largu 30 ditë pas mbylljes të së njejtit.

III. Obligohet Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm që të bëjnë shpalljen e ankandit publik në pajtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

V. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e miratimit dhe konfirmi mbi ligjshmërinë e tij nga ana e MAPL-së dhe do të publikohet në Web faqen zyrtare të Komunës

01 Nr. 4241

Rahovec, 31.10.2014

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC



KRYESUESI I KUVENDIT

Nahit Elshani